



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC



KABINETI I KRYETARIT TE KOMUNES / KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 524 Nr. i faq./Br.str./No.pg 146

Data/Datum/Date 25/23

RAHOVEC / ORAHOVAC

KOMUNA RAHOVEC

BULETINI MUJOR KOMUNAL  
PRILL 2023



## **PËRMBAJTJA**

HYRJE.....	2
AKTIVITETE TË KRYETARIT DHE TË DREJTORËVE TË DREJTORIVE.....	3
PËRFUNDIM .....	10

## HYRJE

*Ky buletin është krijuar me idenë e promovimit të aktiviteteve të Kryetarit të Komunës dhe të drejtorëve të drejtorive, gjatë muajve të vitit 2023.*

*Rrëndësia e botimit të buletinit mujor qëndron në dhënien e mundësisë për informacionet mbi vendimet, zbatimin e politikave dhe rezultatet e aktiviteteve të Komunës së Rahovecit, në mënyrë të tillë që t'i mundësojmë qytetarit të ndjekë dhe të kontribuojë në mënyrë efektive në punën e institucioneve lokale.*

*Muaji prill i vitit 2023, është karakterizuar me një sërë aktiviteteve të Kryetarit dhe të drejtorëve të drejtorive.*

*Me anë të këtij buletini mujor për muajin prill, ne jemi munduar të paraqesim me fotografi dhe në detaje aktiviteteve të Kryetarit të Komunës dhe të drejtorëve të drejtorive në Komunën e Rahovecit.*

## AKTIVITETE TË KRYETARIT DHE TË DREJTORËVE TË DREJTORIVE



Kryetari Latifi, së bashku me bashkëpunëtorë, në prani të familjarëve dhe të bashkëlufetarëve, përkujtuan 2 prillin e vitit 1999, ditën ku forcat serbe përdorën edhe aeroplanët luftarakë kundër qytetarëve të Nagacit dhe të fshatrave përreth, të cilët, për të shpëtuar nga vdekja, ishin strehuar në këtë fshat. Në mëngjesin e hershëm të datës 2 prill 1999, bombat vrastare shkaktuan vdekjen e dhjetëra njerëzve tanë, të grave, të burrave e të djemve, të pleqve e të fëmijëve. Në mes të dhimbjes së madhe dhe krenarisë legjitime, 24 vjet pas luftës, para nesh mbetet detyrë e përhershme që ta forcojmë lirinë dhe shtetin tonë i cili lindi nga gjaku i dëshmorëve nga Nagaci, si: Nesimi Elshani, Habib Gashi dhe i pesë të martirizuarve nga ky fshat.

Kryetari Latifi, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, në prani të familjarëve të dëshmorëve e të martirëve, të përfaqësuesve të OVL-së e bashkëqytetarë të shumtë, nderuan kujtimin për tërë atë sakrificë sublimë të 9 dëshmorëve të kombit dhe 34 martirëve nga Hoça e Vogël.



Kryetari Latifi, ka vazhduar angazhimin e pesë praktikanteve, me pagesë, edhe për tre muaj në institucione publike dhe OJQ, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me projektin ReLOaD2 - Programi për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP), përmes së cilës synohet forcimi i kapaciteteve të komunës dhe rritja e bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile në nivel lokal.

Së bashku me drejtorin e DKA-së, z. Avni Morina, Kryetari Latifi mbajti takimin e radhës me drejtorët e shkollave dhe me kryetarët e këshillave drejtuese të shkollave të komunës sonë. Në këtë takim, ishin të pranishëm edhe komandanti i stacionit policor në Rahovec dhe kryetarja e këshillit komunal të prindërve. Çështjet si mbarëvajtja e procesit edukativo-arsimor, aspektet e sigurisë në shkolla, funksionimi i mirë i organeve drejtuese të shkollave dhe koordinimi i aktiviteteve të përbashkëta, ishin tema për të cilat diskutuan sot.



Pas zbatimit të dy projekteve, atë të ndërmarrjes së masave të efijencës së energjisë dhe projektit të riparimeve të brendshme, investime këto të komunës sonë, nxënësit dhe mësimdhënësit e SHFMU "Bekim Sylka" u rikthyen në objektin e tyre. Me këtë rast, Kryetari, i shoqëruar nga nënkryetari i komunës, drejtori i arsimit, zyrtarët e arsimit dhe në prani të drejtoreshës së shkollës, mësimdhënësve dhe nxënësve, u përurua realizimi i këtyre dy projekteve.

12 prilli i vitit 1999, për bashkëqytetarët e Pataqanit të Ulët, do të mbetet i pashlyer në kujtesën tonë dhe të brezave që vijnë. Në 24-vjetorin e përjetësimit, janë përkujtuar dëshmorët: Reshat Zeka, Sadki Sylejmani, Bekim Ahmeti e Namik Zeka. Gjithashtu, u përkujtuan edhe 3 qytetarët e paarmatosur që u vranë nga forcat serbe në vitin 1998: Shemsie Hoti e Sutki Hoti nga ky fshat dhe Ferat Daka nga Rahoveci.





Në 24-vjetorin e rënies në fushëbetejë të "Rrezet e Krushës" të dëshmorëve Dalip Behra dhe Bekim Gashi, nderuam kujtimin për jetën, veprën dhe sakrificën e tyre për liri!

**KOMITETI PËR KOMUNITETE MBAJTI MBLEDHJEN E RREGULLT, TË TRETËN PËR VITIN 2023.**

Në sallën e kuvendit komunal, Komiteti për Komunitete i Komunës së Rahovecit, mbajti takimin e rregullt. Ky ishte RENDI I DITËS:

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Zbatueshmëria e "Planit Komunal të Veprimit për të Zhvendosurit dhe Zgjidhje të Qëndrueshme" në Komunën e Rahovecit 2023-2025;
3. Respektimi i përdorimit të gjuhëve zyrtare në institucionet publike të Komunës së Rahovecit;
4. Të ndryshme.



Bashkë me përfaqësues të USAID-it nga projekti për qeverisjen e pronës, Kryetari Latifi, me bashkëpunëtorë, mbajti takimin e dytë të Këshillit Publiko-Privat, si trupë këshilldhënëse, me qëllim të ofrimit të shërbimeve dhe përmirësimit të klimës së të bërit biznes në komunën tonë. Në këtë takim diskutuan për Planin Zhvillimor Komunal dhe mundësitë që jep ky plan për bizneset, për Listën e Pronave Komunale për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim, për nevojat e sektorit privat për shfrytëzimin e pronës komunale.

Në 24 - vjetorin e rënies heroike, Smajl Latifi, me bashkëpunëtorë e qytetarë të shumtë, përkujtuan dëshmorët e kombit, Visar Hoti dhe Safet Latifi, të cilët në kohën kur Kosova kishte nevojë më së shumti, kapën armët dhe luftuan kundër pushtuesit.

Veprimtaria e Visarit dhe e Safetit është e gjallë, e prekshme dhe jehonat e të bëmave të tyre jetojnë ende në mendjet e zemrat tona. Atë e ndiejmë dhe e prekim çdo ditë. Në misionin e tyre fisnik, rrugëtuan krenarë, ballëllartë dhe pa u hamendur.

Nuk u zbrapsën deri më 18 prill, kur edhe do të bien heroikisht në logun ku trimëria do të fitojë edhe një përmasë të re. Me aktin heroik të tyre nderuan veten dhe luftën, pasuruan traditën luftarake të shqiptarëve.



Kryetari Latifi, në zyrën e tij, priti njërin nga trembëdhjetë të mbijetuarit e Masakrës së 31 marsit në Pastasel, Shaq Gjemaj nga Guri i Kuq. Atë ditë kur forcat barbare serbe ekzekutuan dhe masakruan 106 qytetarë shqiptarë të moshave të ndryshme e të të dy gjinive, jetën e këtij burri vetëm një fije e hollë e ndante nga vdekja, vdekje të cilën e panë me sy, por, për fatin e tyre të mirë, shpëtuan për t'u bërë rrëfimtarë dhe dëshmitarë të gjallë të atij tmerrri. Si Kryetar Komune, sot, në shenjë respekti për gjithë atë çka këta përjetuan, i ka dhënë mirënjohjen me këtë motivacion: "Për mundin, sakrificën dhe dëshmitë e luftës, paraqitur edhe para Tribunalit Ndërkombëtar të Krimeve të Luftës në Hagë, për zbardhjen e krimeve serbe".

#### U MBAJT MBLEDHJA E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA (KPF), E KATËRTA PËR KËTË VIT



## SHËNOHET 22 PRILLI – DITA E TOKËS

Në kuadër të kësaj date, u shënua "DITA E TOKËS", me disa veprime të thjeshta që mund të bëjmë çdo ditë për një Tokë më të mirë, si: mbjellja e luleve sezonale në qytetin e Rahovecit dhe në fshatra, pastrimi vullnetar i disa rrugëve në qytet - nga oborri i Komunës e deri te varrezat e dëshmorëve, pastrimi i mjediseve përreth objekteve shkollore, eliminimi i deponive ilegale etj.



Në 24-vjetorin e rënies së dëshmorit Hamëz Thaçi, drejtorë të drejtorive komunale së bashku me përfaqësues të OVL-së, kryetarin e fshatit, me drejtorin e shkollës dhe në prani të familjes së dëshmorit e të qytetarëve nga Xërxa, bënë homazhe dhe nderime pranë bustit të dëshmorit Hamëz Thaçi. Dëshmori Hamëz Thaçi, ashtu sikur të gjithë dëshmorët e tjerë të atdheut, do të kujtohen përherë dhe me përvullje para jetës dhe veprës së tyre, sakrificës sublime dhe përjetësimit të tyre gjatë luftës çlirimtare.

## NË BIBLIOTEKËN KOMUNALE "SULEJMAN KRASNIQI" SHËNOHET DITA BOTËRORE E LIBRIT

Nën organizimin e DKRS-së, shoqatës "Hareja" dhe Klubit Letrar "Xhevdet Bajraj", sot, në prezencë të Nënkryetarit Fatmir Iska, në mjediset e bibliotekës komunale "Sulejman Krasniqi", në Rahovec, u shënua Dita Botërore e Librit.

Në këtë debat kushtuar librit, u fol për rëndësinë e të lexuarit, gjendjen e bibliotekave në komunën e Rahovecit dhe nevojën e furnizimit të rregullt me literaturë të nevojshme e të kërkuar nga lexuesit. Para një numri të madh të fëmijëve nga shoqata Hareja dhe të poetëve të Komunës së Rahovecit, drejtori i DKRS-së, z. Afrim Dina, prezantoi punën dhe angazhimet që janë bërë e po bëhen për rritjen e nivelit të lexueshmërisë.







Shënohet 25 – vjetori i daljes së parë publike e UÇK-së në Drenoc të Rahovecit.

Drenoci ishte pikënisja e UÇK-së për Zonën Operative të Pashtrikut, prej ku do të dilnin shumë heronj e dëshmorë trima, që do të sakrifkoheshin për lirinë e Kosovës.

Dalja e UÇK-së më 26 prill e më pas beteja e parë frontale në Anadrini, e fituar në ditën e 12 majit dhe e ajo 14 majit, si dhe betejat që pasuan, i dhanë kësaj lufte tjetër dimension. Toka "u stolis me varre", por nga ai gjak mbinë filizat e shpresës që do të japin frutat e ëmbla të lirisë që po i shijojmë sot.

Kryetari Latifi priti në takim kryetarin e Këshillit të Qarkut të Kukësit, z. Avdullah Domi. Biseduan për mundësitë e reja të bashkëpunimit në projekte ndërkufitare të financuara nga fondet e BE-së.



Kryetari Latifi, bashkë me bashkëpunëtorë e qytetarë, ndezën flakadanë në Krushë të Madhe, për t'i përkujtuar 64 të zhdukurit me dhunë, ende të pagjetur, nga Krusha e Madhe, 103 nga komuna e Rahovecit dhe 1617 të pagjeturit në tërë Kosovën.

Kryetari Latifi, bashkë me drejtorin e DKRS-së, z. Afrim Dina, bashkëpunëtorë, si dhe në prezencën e shumë qytetarëve të pranishëm, përruan fushën sportive në Gexhë, një investim ky nga Komuna e Rahovecit, respektivisht DKRS.

Në këtë fushë të bukur, të rinjtë dhe të rejt mund të zhvillojnë aktivitete sportive në futboll, basketboll, hendboll dhe volejboll. Këtë fushë do ta shfrytëzojnë edhe nxënësit e mësimdhënësit e shkollës së fshatit.



#### 42 Plugje pesëkrahëshe për fermerët tanë

Përkushtimi dhe interesimi i përhershëm i qeverisë lokale për të vënë në krye të agjendës zhvillimore bujkun rahovecas, u dëshmuua edhe sot.

Bashkë me drejtorin e bujqësisë, Berat Duraku dhe bashkëpunëtorë të tjerë, Kryetari Latifi ka filluar procesin e shpërndarjes së mekanizmit bujqësor për 42 fermerë.

Edhe një lajm i mirë për qytetarët e Rahovecit Komuna e Rahovecit fiton grant në vlerë: 102.500 euro nga Ministria e Shëndetësisë.

Falë programit të vizitave shtëpiake për nëna dhe fëmijë 0-3 vjeç dhe numrit të vizitave të realizuara nga stafi i QKMF "DR. FAHREDIN HOTI".

Ky grant vjen si rezultat i punës së jashtëzakonshme që kanë bërë ekipet shëndetësore në ofrimin e shërbimeve mobile për nënat lehona dhe fëmijët.



## PËRFUNDIM

*Ky buletin përmbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë muajit prill 2023.*

*Fusha e qeverisjes së mirë është mjaft e gjerë, e një aspekt i rëndësishëm i saj që është i pashmangshëm për ta plasuar qytetarin në vend qendror është liria e informimit.*

*Informacioni është themeli i qeverisjes së mirë, jo vetëm sepse e rrit efikasitetin, porse i fuqizon qytetarët dhe mundëson shpërndarje të barabartë të përfitimeve nga zhvillimi i përgjithshëm në vend, andaj duke dashur që të jetë sa më transparente me publikun, Komuna e Rahovecit përmes këtij buletini mujor ka ofruar një pasqyrë të përgjithshme të aktiviteteve të saj, për t`iu dhënë mundësi qytetarëve që të njohin dhe vlerësojnë punën e institucioneve komunale.*

*Komuna e Rahovecit ka vënë në funksion këto parime përmes formave të ndryshme të komunikimit me qytetarë, takimeve të drejtpërdrejta, informimit publik dhe çfarëdo metode tjetër përmes së cilës transparenca të ndikojë në avancimin e vetëqeverisjes lokale.*

*Përveç konsultimit dhe komunikimit, këto dokumente forcojnë lidhjet e qytetarëve me komunën dhe rrisin besimin që e gëzojnë zyrtarët publik në nivel lokal.*

*Rahovec, prill 2023*